- Duhet të ketë autonomi 1 orë për 5300W, 3 orë për 2300W, 8 orë për 1000W
- Duhet të ketë 32 qarqe.
- Secili qark duhet të mbajë deri në 20 ndriçues (Exit po emergjence)
- I gjithë sistemi duhet të mbajë të paktën 640 ndriçues
- Ushqimi 400V AC
- Dalja 216V DC + -15%
- Temperatura e operimit 0°C deri në 35 °C
- IP20
- Në përputhje me standartet DIN VDE 0100-718, DIN EN 50172, E DIN VDE 0108-100 and ÖVE/ÖNORM E8002
- Memorie të testeve deri në 5 vjet
- Ekran LCD ku duhet midis të tjerash të pasqyrohet:
  - Funksionimi i rrjetit
  - Funksionimi i baterisë
  - Mosfunksionim sistemi
  - Karikimi
  - Shkarkimi
- Të jetë shumë gjuhësh dhe me kod
- Kart memorie
- RS-2323
- Ethernet
- Sensor temperature për bateritë
- Kontrolleri duhet të përfshijë:
  - Monitorimi i tensionit të baterisë, shkarkimi, monitorimi i rrjedhjeve me tokën
  - Mbrojtje nga shkarkimet, programim i qarqeve dalëse, programim i moduleve
- Module të brendshme I/O



### Specifikime Teknike - Projekti Elektrik

Ndriçimi i daljes (Exit) dhe ai i emergjencës duhet të behet në përputhje me CEI 64-8, EN1838. Ndriçimi i emergjencës do të jetë i pranishëm në secilën dhomë teknike si dhe në gjithë ambientet e përbashkëta. Ky ndriçim duhet të realizojë një fluks minimal ndriçimi në moment avarie të ndriçimit normal të punës. Gjithashtu në dhomat e pacientëve njëra nga linjat do të jetë linjë e cila do të furnizohet nga UPS 3.

Ndriçuesit e emergjencës duhet të ndizen automatikisht në rast mosprezence tensioni në rrjet. Të gjithë kabllot e ushqimit do të jene të tipit FTG10(O)M1, rezistent ndaj zjarrit dhe me emision shumë të ulët tymi e gazi korroziv, ose të jenë të shtrira në kanalinë të dedikuara për shërbimet e sigurisë.

Në çdo rast, ndriçimi minimal nuk duhet të rezultojë më pak se 5 lx në planin horizontal, në lartësinë 1m nga dyshemeja te shkallët dhe dyerve të daljes, dhe jo me pak se 2 lx në çdo ambient në të cilin ka akses publiku. Koha e komutimit  $\leq 0.5s$  për ambientet e grupit 2, si dhe  $\leq 0.15s$  për ato te grupit 0.

#### ➤ Ndriçues emergjence:

- Ndriçues LED
- Tensioni operimit 230V/216V DC
- 0.5 lux ne 15m lartësi
- LED 1x10W
- Orë Pune 100 000
- 380lm
- Fuqia 24W
- Certifikimi: CE ENEC
- Shkalla mbrojtjes IP65
- Klasa II e izolimit
- Normat EN60598-1, EN60598-2-22 , EN62471 – Group 1



#### ➤ Ndriçuesit EXIT:

Këta ndriçues do të programohen në mënyrë të tillë që të jenë gjithmonë të ndezur SE.

- Ndriçues LED

### Specifikime Teknike - Projekti Elektrik

- Tensioni operimit 230V/216V DC
- LED 1.8W
- 40lm
- Certifikimi: CE ENEC
- Shkalla mbrojtjes IP40
- Klasa II e izolimit
- Normat EN60598-1, EN60598-2-22 , EN62034, EN62471 – Group 0
- Distance vizive: 26m
- Temperatura e operimit 0°C deri ne 40 °C



Ndriçimi exit, i cili shërben për orientimin gjatë evakuimit të godinës, duhet të jetë në përputhje të plotë me skemën e evakuimit. Pra duhet të kemi rakordim të plotë midis skemës së evakuimit dhe pozicionimit të ndriçuesve exit.

#### 1.7 Sistemi DATA dhe telefoni

Rrjeti i shpërndarjes së sinjalit data është parashikuar të jetë i një topologjie radiale. Sipas kërkesës, është parashikuar një njësi Rack qendrore 19" 42U, nga e cila do të dalin gjithë linjat me fibër të furnizimit me sinjal data. Çdo bllok do të gjatësinë e tyre. Në njësinë Rack është parashikuar një rezervë, e cila do të shërbejë për një zhvillim të mëtejshëm ose për kërkesa specifike që mund të ketë në të ardhmen.

Njësi Rack është rezervuar si ngarkesë në UPS, duke siguruar vazhdimësinë e punës dhe në mungesë të rrjetit deri në futjen në punë të burimeve të tjera të rezervimit. Ky rezervim shërben për të mbrojtur pajisjet elektronike nga shkëputja e energjisë, duke patur në konsideratë ndikimin negativ që do të kishte kjo shkeputje e energjisë mbi këto pajisje.

Si pjesë e rrjetit të shpërndarjes së LAN janë prizat fundore. Prizat e rrjetit të LAN vendosen në të njëjtën lartësi me prizat e tensionit. Ato do të jenë të tipit brenda në mur, testaleta etj. Gjithashtu postet e punës si dhe ambientet e tjera ku është e nevojshme janë të pajisura me priza RJ45.

Prizat e rrjetit LAN janë të njëjta me ato të sistemit të telefonisë tip, RJ45- kategoria 6.

### Specifikime Teknike - Projekti Elektrik

Sistemi telefonik ka si funksion sigurimin e shërbimit telefonik për postet e punës nëpër zyra. Sistemi do të jetë i bazuar në teknologjinë VOIP (Voice Over IP). Në rack-un kryesor të data-ve do të jetë parashikuar switchi me porta PoE për çdo postë telefoni.

➤ Karakteristikat teknike:

- Kabllimi i shërbimit të IT-së duhet të përputhet me rregulloren EN 50174 klasa E.
- Secili kabëll duhet të jetë tip FTP cat 6 për instalime të brendshme. I gjithë sistemi kabllor duhet të matet pas instalimit. Raportet e shkruara duhet t'i dorëzohen klientit pas punës, për t'i treguar rezultatet. Në përgjithësi të gjitha postet e punës janë të pajisur me dy priza RJ45 cat 6. Furnizimi do bëhet me dy linja FTP cat6 bazuar në sistemin e strukturës së kabllimit. Linjat duhet të lidhen në çdo fund që është i gatshëm për operim. Etiketimi duhet të behet nga të dyja anët e linjës së kabllit. Për secilën dalje, duhet të ketë një dalje në patch panel.
- Raku është model bazë i prodhuar nga fabrika me komponentët përkatës: derë e përparme me pamje sigurie 3 mm dhe çelës të përshtatshëm të mbyllur, derë çeliku fletë e gjerë 2 mm nga mbrapa me hapje 130°. Dimensione janë 42HE 800x1000x2000 mm dhe është i pajisur me patchpanele, ventilator, patchguida, e priza universale schuko 10A dhe automat 2 polar 16 A. Si dhe me të gjitha pajisjet e terminimit të fibrës.
- Kablli FTP me këto karakteristika:  
Standartet: EN 50173-1; EN 50288-5-2 ISO/IEC 11801; IEC61156-6 IEEE 802.3af /at / bt  
Përcjellësi: 27AËG, bakërr Ø 0.42 mm  
Izolacioni: Polietilen, 500V  
Impedanca: 100 MHz , 100 ± 5 Ω  
Certifikimi: CE

### 1.8 Sistemi i dedektimit të zjarrit

Sistemi do të jetë i adresueshëm, ku secili dedektor, apo buton manual që do të sinjalizojë, do të paraqitet në panelin e dedektimit të zjarrit me një kod të caktuar, në mënyrë që të behët identifikimi sa më i shpejtë i ambientit ku është dedektuar zjarri.

Sistemi i detektimit të zjarrit lidhet me sistemin audio për të realizuar dërgimin e komandës për thirrjen e evakuimit.

*Për sistemin e detektimit të zjarrit të referohen vizatimet e projektit.*

➤ Sistemi do të komunikojë dhe do të ketë ndërfaqe me:

- Sistemin qendror për integrimin me sistemet e sigurisë

### Specifikime Teknike - Projekti Elektrik

- Centrali i lajmërimit publik për të dhënë mesazhet automatike në rastet e evakuimit kur nuk ka asnjë ndërhyrje për ta anuluar atë.
- Zonat e mbuluara nga impianti i dedektimit dhe sinjalizimit të zjarrit përfshijnë:
  - Korridorët, sipërfaqet brenda tavaneve të varura, hapësirat e brendshme të repartit, ambientet teknike, dhomat e monitorimit, kanalet e ajrit, ashensorët etj. Për secilin ambient do të përdoret sensori që i korespondon.
- Sistemi dedektimit të zjarrit do të përbëhet nga:
  - Centrali
  - Dedektore të tipologjive të ndryshme
  - Pulsante manualë të cilët aktivizojnë sistemin në rastet e emergjencës.
  - Sinjalizatorë me dritë përsëritës për të gjithë sensorët e instaluar në zona të padukshme si, brenda tavanëve të varur, kanaleve të ajrit etj.
  - Sirena alarmi optike dhe akustike.
  - Modulin e komunikimit me sistemin e lajmërimit zanor.
  - Llampe sinjalizimi për gjendjen e impiantit të dedektimit të zjarrit (impianti në funksion, i çaktivizuar apo në alarm)
  - etj.
- Centrali i dedektimit të zjarrit ka karakteristikat e mëposhtme:
  - I adresueshëm
  - Montim në mur
  - Kompletuar me display LED me ngjyra
  - Me menu interaktive me mundësi përzgjedhje në disa gjuhë (anglisht, italisht etj.)
  - Modular me mundësi zgjerimi modulesh minimumi me 5 module LSN per 3 LOOP-e
  - Instalim lupi deri në 127 pajisje ( detektorë zjarri, butona manuale) / me zona detektimi për çdo lup.
  - I pajisur me modul kontrolli baterish për karikimin dhe për të kontrollu gjendjen e tyre
  - Database për regjistrimin deri në 10000 evente
  - Ndërfaqes printeri për printer të brendshëm
  - Port Ethernet për ndërlidhje me kompjuter, BMS etj
  - EN 54 : Detektimi nga zjarri dhe alarmi
  - ISO 7240 : Detektimi nga zjarri dhe sistemet e alarmit
  - ISO 8421-3 : Mbrojtja nga zjarri – Detektimi nga zjarri dhe alarmi

- Standartet vendase
- Instalimi nga një kontraktor cilësor i çertifikuar
- Certifikimi: CE-VDS

➤ Dedektori optik i tymit:

Në sajë të aftësisë së tij të lartë të përpunimit, është në gjendje të analizojë në mënyrë eficiente gjendjen e zonës së mbrojtur, duke garantuar imunitet të lartë ndaj alarmeve të rreme.

- Analizë sinjalizuese të lidhur me kohën
- Sinjal të lidhur me të dhënat e sensorit
- Inteligjencë të decentralizuar
- Funksion automatik me test të brendshëm
- Përshatje automatike me kushtet mjedisore
- Me memorje të dhënash për alarm dhe veprim
- Me tregues alarmi dhe program te adresueshëm
- Tensioni i operimit 15-33 V DC
- Konsumi < 0.55 mA
- Lageshtia relative 95%
- Temperatura e operimit -10 deri +50 °C

➤ Dedektori i temperaturës:

Ky detektor kontrollon temperaturën e ambientit duke përdorur termistorin, me të cilin është pajisur. Në sajë të algoritmit të analizimit të implementuar në brendësi të tij, garanton përgjigje eficiente dhe imunitet të lartë ndaj alarmeve të rreme. Nëpërmjet programatorit, mund të përshtatet si detektor termik, me prag të fiksuar ose në temperaturë të lartë.

- Standarti bazë për detektorët analogë

➤ Dedektori i kanaleve të ajrit:

Do të përdoret në tubat e ventilimit. Në sajë të aftësisë së tij të lartë të përpunimit, është në gjendje të analizojë në mënyrë eficiente gjendjen e zonës së mbrojtur, duke garantuar imunitet të lartë ndaj alarmeve të rreme.

- Tensioni i operimit 15-33 V DC
- Konsumi < 0.55 mA
- Lagështia relative 95%
- Temperatura e operimit 0 deri +50 °C

### Specifikime Teknike - Projekti Elektrik

- IP30
- Sinjalizuesi i jashtëm adresueshëm ose modul+konvencional me dritë:

Me konsum minimal, i prshtatur për të gjithë centralet analoge të adresueshme të detektimit të zjarrit, me ushqim në mënyrë direkte nga loop.

- Fuqia e emetimit të tingullit, e rregullueshme, deri në 100dB
- Projekt kompakt
- Tonalitet me përzgjedhje nëpërmjet DIP-SËITCH
- Me ose pa sinjalizues me dritë të inkuorporuar
- Tension veprues 18-28 V DC
- Rryma e alarmit në 12V DC rreth 3mA
- Rryma e alarmit në 24V DC rreth 5mA
- Nivel zëri në 24V DC 112dB( A)
- Temperatura e ambientit -25 °C ... 70 °C
- Tipi i mbrojtjes IP 65

- Sinjalizuesi i brendshëm adresueshëm ose modul+konvencional me optik edhe akustik:

Sinjalizatori optik/akustik, i pajisur me një modul Hyrje/Dalje.

- Tension veprues 12 ose 24 V DC
- Mbrojtje nga ndryshimi polaritetit
- Konsumi rreth 36mA
- Nivel zëri në 24V DC 112+3 dB( A)
- Temperatura e ambientit -10 °C ... 55 °C
- Tipi i mbrojtjes IP 65

- Pulsanti i alarmit i adresueshëm ose modul+konvencional me korigjim:

Pulsanti i alarmit VCP100 lidhet në mënyrë direkte me loop e detektimit të centraleve analoge të adresueshme. Duke shtypur në pjesën e aktivizimit (që tregohet qartë sipas përshkrimeve të Normes EN54-11), mekanizmi i thjeshtë, por i mprehtë riprodhon efektin e caktuar nga thyerja e një xhami, pulsanti mund të përpunohet thjeshtësisht duke përdorur çelësin plastik në aparaturë.

Ky tip pulsanti është ideal për të gjitha ato aplikacione subjekte të aktivacioneve të retime frekvente (shkolla, qendra tregtare dhe vende të tjera publike). Ngjyra e kuqe.

- Tensioni i operimit 24V DC
- Konsumi < 0.26 mA

### Specifikime Teknike - Projekti Elektrik

- EN54-11
- Temperatura e operimit -25 deri +70 °C
- IP 54

➤ Indikatorit në distancë, fleshues led:

Përsëritës optik me LED, që mundëson relikimin në distancë të tregimit të sensorit në alarm.

- Fleshues: 360°
- Konsumi: 3-30 mA
- Lagështia relative: 95%
- Temperatura e operimit: -20 deri +65 °C
- IP: 40

➤ Mbajtës magnetik dere:

- Tensioni i operimit: 24V DC
- Këndi i rrotullimit: 90°
- Konsumi: 63 mA
- Forca mbajtëse: 490N
- Temperatura e operimit: 0 deri +50 °C, EN 60529
- IP 40

➤ Kombinator Telefonik:

Është një telekomandë thirrëse GSM, i përshtatshëm për t'u integruar me sistemet inteligjente të sigurisë. Kontrollon 5 linja të ndryshme të konfiguruar në shumë drejtime si hyrje dhe dalje. Pasi ka kontrolluar ambientin, dalja mund të menaxhohet nga një thirrje telefonike, mesazh i shkruar ose mesazh zanor me njohje të thirrësit. Numrat janë të lirshëm t'i shtohen thirrjeve, SMS-ve, protokolleve dixhitale Kontakt ID.

## 1.9 Sistemi i evakuimit zanor

Sistemi i evakuimit zanor do të realizohet nisur nga kërkesat e sistemeve të sigurisë dhe do të integrohet bashkë me to në bazë të normave europiane EN 60849, EN54-16.

➤ Ky sistem do të realizojë këto funksione:

- Kominikimin e lajmërimeve ose evakuimeve në rastet e alarmeve të dhëna nga centrali i zjarrit.
- Lajmërime të ndryshme nga personeli përgjegjës apo instanca shtetërore (Zjarrfikëës)



### Specifikime Teknike - Projekti Elektrik

- Të transmetojë thirrje të ndryshme të integruara me sistemin e thirrjeve etj.
- Centrali i evakuimit:

Të gjitha zonat do të mblidhen tek ky central dhe zonat mund të komandohen në mënyrë individuale dhe të gjitha në grup. Ky central do të lidhet me centralin e zjarrit dhe në rast se kemi event në centralin e zjarrit, do të kemi anulim automatik në centralin e evakuimit.

Parametrat minimal të centralit të evakuimit:

- Buton emergjence për kalimin direkt në evakuim me funksion prioritet
- Me 6 zona të ndara dhe me mundësi komandimi të tyre on/off dhe me kontroll volumi
- Zonat me tension 100V për lidhjen e altoparlantëve.
- Me amplifikator te brendshëm 240W dhe me mundësi zgjerimi me amplifikator të jashtëm në paralel
- Hyrje BGM për mikrofon të jashtëm
- Hyrje RCA për lidhje me pajisje të jashtme muzike (MP3 Player etj.)
- Pajisja rackmounted që të montohet brenda në rack
- Certifikimi: CE
- Memorje të brendshme 16MB për ruajtjen deri në 255 mesazhe zanore për evakuim në format WAV.
- Protokolle të përputhshme me sistemin BMS
- Tensioni 230/115VAC,  $\pm 15\%$ , 50/60 Hz
- Konsumi 600VA
- Frekuencat 60 Hz to 18 kHz (+1/-3 dB at -10 dB ref. rated output)
- Ndjeshmëria 1 mV (mic), 1 V (line)

- Amplifikator i fuqisë

Amplifikatori i fuqisë i përzgjedhur do të mbulojë fuqinë e të gjithë altoparlantëve së bashku, në mënyrë që të mos ketë mbingarkesë të sistemit, sidomos në rast të lajmërimeve të emergjencave.

Parametrat minimal të amplifikatorit:

- Pajisje rackmounted që të montohet brenda në rack
- Certifikimi CE
- Me llampa LED ne pjesën ballore që tregojnë gjendjen e zonave
- I pajisur me mbrojtje nga mbingarkesa ose nga lidhjet e shkurtra
- Mbrojtje nga mbinxehja, duke e stakuar automatikisht
- Daljet për lidhje altoparlant 70V, 100V, 8ohm

### Specifikime Teknike - Projekti Elektrik

- Certifikime EN 60065, EN 50130-4, EN 55103-1, EN 54-16
- Tensioni 220-230VAC,  $\pm 10\%$ , 50/60 Hz
- Konsumi 2200VA
- Lagështia relative  $< 95\%$
- Temperatura e operimit -10 deri +55 °C

#### ➤ Panel audio zjarrfikëse

Do të shërbejë për të kontrolluar manualisht sistemin e evakuimit zanor. Ai shërben për të njoftuar në mënyrë të menjëhershme çfarëdolloj njoftimi të nevojshem nga strukturat e specializuara.

- Tensioni 24V DC +20% -10%
- Lagështia relative  $< 95\%$
- Temperatura e operimit -10 deri +55 °C

#### ➤ Tuner CD Player

Paisja Tuner do të shërbejë për të vendosur muzikë sfondi në këto ambiente ku ka altoparlantë. Pajisja duhet të kete mundësi për të vendosur muzikë në radio, me CD, me USB ose kartë memorie SD.

- Montimi në rack
- Tensioni 115 - 230 VAC  $\pm 10\%$ , 50/60 Hz
- Konsumi 10 ă
- Lagështia relative  $< 95\%$
- Temperaturë e operimit -25 deri +45 °C
- Certifikimi IEC/EN 60065, EN 55013+A1+A2, EN 61000-3-2, EN 61000-3-3+A1 2006/95/CE LVD Directive, 2004/108/CE EMC, IEC EN 55020+A2+EC

#### ➤ Mikrofon

Mikrofonat do të shërbejnë për të dhënë mesazhe të ndryshme nga stafi i spitalit, ku do të vendoset nga një mikrofon në çdo bllok.

- Mikrofon me 6 zona
- Tensioni 24V
- Konsumi  $< 30\text{mA}$
- Ndjeshmëria 85 dB SPL
- Frekuenca 100 Hz to 16 kHz
- Impedanca 200 ohm
- Lagështia relative  $< 95\%$

### Specifikime Teknike - Projekti Elektrik

- Temperatura e operimit -10 deri +45 °C
- Altoparlantët

Altoparlantët janë inkaso/jashtë muri 6W/10W, që do të instalohen në tavanin e varur në ambientet e përbashkëta, për të pasur një mbulim së më të mirë të të gjitha ambienteve. Instalimi i tyre duhet të bëhet konform sipas shpërndarjes në projekt.

Inkaso:

- Çertifikimi EN 54-24
- Fuqia 9/ 6 / 3 / 1.5 / 0.75W
- Tensioni 100V
- Niveli i Zhurmës 98 dB / 90 dB (SPL)
- Frekuenca 90 Hz to 20 kHz
- Lagështia relative <95%
- Temperatura e operimit -25 deri +55 °C

Jashtë muri:

- Certifikimi EN 54-24
- Fuqia 10 / 5 / 2.5 W
- Tensioni 100V
- Niveli i Zhurmës 96 dB / 86 dB (SPL)
- Frekuenca 75 Hz to 20 kHz
- Lagështia relative <95%
- Temperatura e operimit -25 deri +55 °C
- IP65

#### 1.10 Impianti Wi-Fi

Është parashikuar që Qendra Spitalore të jetë e pajisur me rrjet Wi-Fi për përdorim alternativ, ose në shtesë të rrjetit të operatorëve publik për akses në shërbimet internet dhe për lidhjen e aparaturave të menaxhimit të impianteve teknologjike.

Një linjë zone lokale LAN pa përcjellës (ëireless) lejon të lidhen kompjutara apo pajisje smart të përdorimit të përditshëm, pa nevojën e linjave kabllore.

Zhvillimi i rrjetit ëireless bazohet në faktin që të gjithë telefonat dhe pajisjet portabël janë paisur me teknologjinë Wi-Fi.

Poseduesit mund të hyjnë me siguri në burimet e rrjetit nga çdo pikë brenda zonës së mbulimit. Zona e mbulimit në rastin konkret formohet nga ambientet e dhomave dhe ambientet e përbashkëta të shërbimit.

Pajisjet e shpërndarëse, antenat WI-FI duhet të sigurojnë vazhdimësi lidhjeje të pandërprerë edhe gjatë lëvizjes nga një zonë mbulimi, në një tjetër.

### 1.11 Impianti i sinjalit TV-TVSAT

Parashikohet instalimi i një sistemi antenash në tarracë për marrjen e sinjalit TV tokësor analog, dixhital dhe sinjalit TV satelitor.

Për marrjen e kanaleve TV analoge dhe dixhitale parashikohet një central i programueshëm me 25 kanale, për të mundësuar larmishmëri gjuhësore stacionesh, me filtra selektiv me kontroll automatik, ushqyesi, matrica e shpërndarjes dhe amplifikatori final, komplet me antenën për marrjen e bandës.

Marrja e kanaleve SAT përmban antenën parabolike me dy LNB 4 dalje H/V për dy satelite. Sistemi shpërndarës do të jetë njëkabllo i instaluar në kanal të dedikuar në pusin teknik, nga ku me derivatorë dhe partitore sinjali shpërndahet në të gjitha dhomat dhe ambientet e spitalit.

#### ➤ Antenë UHF

Antena për sinjalin UHF me kërkesa minimale:

- Duhet të përmbajë 10 elementë
- Të reduktojë impaktin e sinjalit LTE në sinjalin televiziv
- Rezistencë linje 75Ohm
- Polarizim Horizontal ose Vertikal
- Bandë 470-790MHz
- Me konektor F
- Certifikimi: CE

#### ➤ Amplifikator Tokësor

Amplifikatori për amplifikimin e sinjalit TV me kërkesa minimale:

- Duhet të ofrojë mundësinë për rregullim të sinjalit televiziv në dalje
- Duhet të kenë teknologjinë e mbajtjes konstant të sinjalit RF, që është i regjistruar për secilën dalje (stabilizimin e sinjalit të kërkuar).
- Duhet të ofrojë mbrojtje të lartë ndaj interreferencave që vijnë për shkak të sinjaleve LTE
- Amplifikime të pavarura për daljet e ndryshme.
- Hyrje për ushqyes pranë tij dhe llampa LED, që tregojnë gjendjen e tij si dhe autoreset për mbrojtjen nga lidhjet e shkurtra.
- Certifikimi: CE

## 1.12 Impianti i akses kontrollit

Sistemi elektronik i akses kontrollit synon të organizojë dhe të sigurojë në mënyre të thjeshtë dhe fleksibël aksesin në dhoma të dedikuara. Hyrjet dhe daljet kontrollohen dhe monitorohen nga centrali i aksesit. Ky central kontrollon bravat dhe kundrabravat e dymve, që në momentin kur çekon një kartë, hapet ajo derë si dhe në momentin që kjo derë hapet me forcë, pa u çekuar, aksesit kalon në alarm. Në momentin që godina ndodhet në alarm evakuimi, ky sistem duhet të dalë automatikisht jashtë pune.

- Akses kontrolli standart, 230V AC
  - Kontrolli automatik
  - Kontrolli i ngjarjes fleksibël dhe të pershtatshme nëpërmjet modulit hyrës dhe dalës
  - Kontroll makro (sistem të kontrollit të detektimit nga ndërhyrjet, kontroll ashensori, etj.)
  - Bllokimin e aksesit të përsëritur
  
- Lexues karte
  - Standartet ISO 15693 dhe 14443 A
  - Standarti i operimit simultant multi RF
  - Siguri e enkriptim DES / 3DES
  - Sistem kontrolli fizik master dhe çelës menaxhimi automatik
  - Adresë vendodhjeje e thjeshtë RS-485, manuale ose automatike
  
- Çelës elektrik për portën që ka akses
- Buton alarmit
- Buton për dalje
- Karta aksesi ID të printueshme

## 1.13 Sistemi thirrjes së infermieres (Nurse Call)

Sistemi Nurse Call (Spitalor) përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

- Centrali i sistemit të thirrjes së infermieres:
  - ADL-EF Line Coupler
  - Ethernet
  - Tensioni 24V DC
  - Instalimi në shin din.
  - CE

**Specifikime Teknike - Projekti Elektrik**



➤ Display



➤ Pulsanti i thirrjes (Te instalohet ne testalet)



➤ Pulsanti thirres per tualetet



➤ Llambë sinjalizimi



➤ Pulsanti i fshirjes:



#### 1.14 Sistemi CCTV

Janë parashikuar për t’u përdorur dy tipe kamerash ku për ambientet e brendshme do të jenë kamera Dome për t’u instaluar në tavanin e varur, ndërsa për në ambientet e jashtme, kamera Bullet, të cilat do të vendosen në fasaden e objektit në lartësi për të monitoruar ambientet hyrëse në objekt. Kamerat duhet të jenë minimumi 5Mpx, me lente varifocale nga 2.4 – 12 mm, me regjistrim deri në 25fps si dhe me infrared IR për të regjistruar natën ose kur në ambiente është errësirë.

➤ Minimumi i kërkesave të NVR:

- Furnizimi 100-240Vac
- Montimi rackmounted për t’u montuar në Rack
- Regjistrimi deri në 12MP
- Kompresimi i regjistrimit H265+
- Mundësi lidhje deri 4 SATA konektor për HDD deri në 8TB
- Kontroll regjistrimi smart me filtra sipas eventeve
- Dalje Video: 2 porta HDMI, VGA
- Dalje Audio: RCA
- Temperaturë pune : -10°C deri në +55°C
- Kontakte të pastra si hyrje ose si dalje te konfigurueshëm
- Mundësi lidhje me tastiere dhe mouse për komandimin e saj
- Port USB për eksportimin e regjistrimeve në raste ngjarjesh

➤ Minimumi i kërkesave për kamerat:

- Furnizimi: PoE
- Lente: 2.8 – 12mm
- Rezelucioni : 720, 1080, HD, Full HD
- Tipi i Lentës: varifocale
- Të kenë: IR LED deri në 30m
- Regjistrimi në ndriçim të ulët : 0.03lux me ngjyra
- Detektim levizje dhe alarmi
- Temperaturë pune : -20oC deri në +60oC

### Specifikime Teknike - Projekti Elektrik

- Kompresimin e videos : H265, H265+, MJPEG
- Numri I fps: deri në 25fps
- Të jenë: OnVif
- Të suportojë : microSD
- Shkalla e mbrojtjes: IP66, IK10
- Certifikimi CE

#### ➤ Monitori LCD:

Monitor LED që shërben për kontrollin, përdorimin e sistemit të CCTV.

#### ➤ Kërkesat minimale:

- Ekran i hapur 22" LCD
- Matrice aktive TFT-LCD-16:9
- Pikseli 0.294mm DP
- Niveli i kontrastit: 400:1
- Ngjyrat 16.7m
- Video: Dsub/DVI
- Koha e përgjigjes 20ms
- Këndi i shkallës së shikimit: 160 gradë
- Rezolucioni maksimal: 1360x768/1280x768
- Certifikimi: CE

I aftë të shfaqë më shumë se 16 piktura ose të ndahet deri në 16 ekrane më të vegjël, me të njëjtën madhësi, i montueshëm në mur ose të qëndrojë në kembë.

### 1.15 Sistemi i Orave

Sistemi i orave të sinkronizuara janë të shpërndara në korridore në të gjitha katet e Qendrës Spitalore, ku në secilën zone kemi nga një central qëndror që komandon orat që janë lidhur në të. Ne total kemi 5 centrale qëndror, që ndodhen në dhomat teknike të blloqeve.

Sistemi i orave duhet të ketë mundësinë e sinkronizimit. Centrali i orave duhet të jetë i pajisur me GPS. Të gjitha orat do të jenë dixhitale me POE.

### 1.16 Sistemi i Menaxhimit të Ndërtesës (BMS)

Sistemi i Menaxhimit të Ndërtesës (BMS) do të përfshijë sistemin HVAC, trajtimin e ajrit, pompat e ndryshme, elektrike dhe përbërësit e tij. Sistemi BMS do të jetë i plotë duke përfshirë të gjitha pajisjet e nevojshme dhe të gjithë softueret e funksionimit dhe aplikacioneve të



### Specifikime Teknike - Projekti Elektrik

nevojshëm për të kryer sekuenat e kontrollit të funksionimit siç kërkohet në këtë specifikim. Të gjithë perberesit e sistemit-stacionet e punës, serveret, kontrolluesit e aplikacioneve, kontrolluesit unitarë, etj., do të komunikojnë duke përdorur protokollin BACnet, ose protokollin LonTalk, ose protokollin Modbus në varësi dhe përputhje me te gjitha pajisjet që do të instalohen.

Sistemi i kontrollit do të përbëhet nga të gjithë kontrollorët e nevojshëm të rrjetit Ethernet, njësitë e pavarura të kontrollit dixhital, stacionet e punës, softueret, sensorët, dhenësit, stafetat, valvulat, operatorët prishës, panelet e kontrollit dhe pajisje të tjera ndihmëse, së bashku me një sistem të plotë të instalimeve elektrike të ndërlidhura për të plotësuar qëllimin e specifikimit dhe për të siguruar një sistem të plotë dhe të funksional.

Zbatuesi do të rishikojë dhe studiojë të gjitha vizatimet e HVAC dhe të gjithë specifikimin, për t'u njohur me pajisjet dhe funksionimin e sistemit dhe për të verifikuar sasitë dhe llojet e prishësve, operatorëve, alarmeve.

Sistemi BMS do të jetë komandues për pjesën HVAC dhe trajtimin e ajrit si dhe komandues ose monitorues për pjesën elektrike dhe përbërësit e tij. Monitorimi konsiston në njoftimin, raportimin, shfaqjen grafike, ruajtjen afatgjatë të të dhënave, mbledhjen automatike të të dhënave dhe veprimet e kontrollit të iniciuara nga operatori. Sistemet HVAC, trajtimi ajrit të instalohet i ndarë nga sistemi elektrik në dy PC, në mënyrë që të ketë mundësinë të operohet nga 2 operatorë të ndryshëm. Nga paisjet mekanike sistemi BMS merr informacionet pra input-et, merr input nga sensorët, gjëndjen e valvulave, monitorimi dhe komandimi i pompave, FC . (sensore, valvula etj si paisje janë pjesë e preventivit mekanik).

Analiza 12.3 e sistemit BMS është vendosur në cdo bllok të SUT. Por nëse rikonstruksioni i SUT do të realizohet i gjithi njëherësh ky zë do të përdoret vetëm një herë, pasi nuk ka nevojë që cdo grup të ketë BMS të ndarë.

#### ➤ Karakteristikat e PC:

- Procesor
  - a) Minimumi: Intel Core i5 @ 2.0 GHz ose ekuivalent
  - b) Rekomanduar: Intel Core i5 @ 3.0 GHz ose më mirë
  
- Memorja fizike
  - a) Minimumi: 4 GB
  - b) Rekomanduar: 8 GB ose më e lartë
  
- Sistemet operative:
  - a) Microsoft Ëindoës Server 2012 64-bit (Standard, Datacenter, Essentials, ose Foundation)
  - b) Microsoft Ëindoës Server 2016 (Standard, Datacenter, Essentials, ose Foundation)
  - c) Microsoft Ëindoës Server 2019 (Standard, Datacenter, Essentials, ose Foundation)

### Specifikime Teknike - Projekti Elektrik

Çdo përdorues në rrjet mund të hyjë në sistem, duke përdorur programin e mëposhtëm:

- Microsoft Edge
- Mozilla Firefox
- Google Chrome
- Safari

Në përputhje me fushëveprimin e punës, sistemi gjithashtu duhet të sigurojë një ndërfaqe grafike, të bazuar në ëeb, të operatorit që lejon qasje të menjëhershme në çdo sistem. Sistemi duhet të lejojë zgjerimin e ardhshëm të pikave hyrëse/dalëse dhe funksioneve të përpunimit/kontrollit.

➤ Sistemi do të përbëhet nga përbërësit e mëposhtëm:

- Postet e punës
- Routeri i Rrjetit i bazuar në Ethernet dhe/ose Kontrolluesit e Serverit të Rrjetit
- Njësitë e Kontrollit Dixhital të Pavarur (SDCU)
- Rrjeti Lokal (LAN) Ethernet 10 ose 100 Mbps
- LAN i Ndërmarrjes Ethernet (IEEE 802.3)
- Sistemi do të mundësojë një arkitekturë të hapur që përdor standardin VNM 709.1
- Sistemi do të mundësojë një arkitekturë që përdor një protokoll të zgjedhur MS/TP 9.6-76.8 KBaud, si protokoll i peëbashkët komunikimi midis të gjithë kontrolluesve dhe funksionalitetit integral ANSI/ASHRAE™ Standard 135-2004, BACnet, për të siguruar ndërveprimin midis të gjithë përbërësve të sistemit
- Mjetet softuerike të kërkuara për menaxhimin e rrjetit të protokollit LonTalk dhe ANSI/ASHRAE™ Standard 135-2004, protokollit BACnet duhet të pajisen me sistemin.

➤ Sistemi dhe elementët e tij do të jenë në përputhje me:

- UL-916.
- UL-864 UULK.
- Të gjitha pajisjet ose tubacionet e përdorura në rrymat e ajrit të kondicionuar, hapësirat ose plenumet e ajrit të kthimit duhet të jenë në përputhje me vlerësimin e kontributit të NFPA 90A Flaka/Tymi/Karburanti prej 25/50/0 dhe të gjitha kodet ose kërkesat e zbatueshme të ndërtimit.
- Të gjitha instalimet elektrike duhet të jenë në përputhje me Kodin Elektrik Kombëtar.
- Të gjithë amortizuesit e tymit do të vlerësohen në përputhje me UL 555S.
- Rregullat e FCC, Pjesa 15 në lidhje me rrezatimin e klasës A për pajisjet kompjuterike dhe pajisjet e komunikimit me fuqi të ulët që veprojnë në mjedise komerciale.
- Rregullat e FCC, Pjesa 68 për modemët e telefonit dhe grupet e të dhënave.

➤ Në sistemin e BMS duhet të kemi parasysh:

### Specifikime Teknike - Projekti Elektrik

- Të gjitha vizatimet do të përgatiten në softuerin Visio Professional ose AutoCAD. Përveç vizatimeve, kontraktuesi duhet të sigurojë një CD, që përmban informacionin.
- Vizatimet duhet të përfshijnë një diagram që përshkruan vendndodhjet e të gjithë kontrolluesve dhe stacioneve të punës, instalimet elektrike të lidhura me rrjetin. Gjithashtu të përfshihen skemat individuale të secilit sistem mekanik që tregojnë pikat e lidhura, duke iu referuar kontrolluesit të tyre të lidhur.
- Kur të dorëzohet sistemi (As-Build) dosja duhet të përmbajë të dhënat e prodhuesit për të gjitha produktet harduerike dhe softuerike të kërkuara.

Duke qenë se sistemi i menaxhimit të ndertesës është specifik, furnizuesi i sistemit BMS do duhet të jetë i çertifikuar sipas IEC 62443-4-1.

Sistemi i menaxhimit do të jetë në përputhje me të gjitha kodet, ligjet dhe organet e Shtetit Shqiptar. Nëse vizatimet dhe/ose specifikimet bien ndesh me kodet, kontraktuesi, me udhëzimin e inxhinierit, do të paraqesë një propozim me modifikimet e duhura në projekt, për të përmbushur kufizimet e kodit.

#### 1.17 Sistemi Ekuipotencial

Ky sistem shërben për të shmangur diferencën e potencialeve të pajisjeve që kane kontakt të drejtëdrejtë me trupin e njeriut. Në çdo kat do të vendoset nga një zbarre ekuipotenciale në dhomat teknike dhe nga ato do të instalojme një unaze me përcjelles bakri në të gjithë gjatësinë e korridorit. Dalja e lidhjeve fundore nga unaza do të bëhet në kuti shpërndarëse me morsetë ekuipotenciale, ku do të lidhen linjat direkte që vijnë nga çdo prizë dhe secila prej tyre do të etiketohet nga të dy krahët e përcjellësit. Sistemi ekuipotencial duhet të jetë i pavarur në të gjithë gjatësinë e tij, nga sistemi i tokëzimit.

Në zbarrat ekuipotenciale do të lidhen të gjitha pjesët metalike që ndodhen në zonat e pacientit, por jo vetëm. Çdo pjesë metalike (Kanalina, tuba metaliket, dritare etj) e cila ndodhet në ambientet e grupit 1 dhe 2, duhet të ekuipotencializohet.

Në ambientet e grupit 2, rezistenca midis zbarrës ekuipotenciale dhe pajisjes nuk duhet t'i kalojë 0.2 ohm.

Në kutinë ekuipotenciale të gjitha linjat duhet të jenë të veçanta dhe të shënuara në trup se kujt pajisje i përkasin.

#### 1.18 Sistemi i Tokëzimit dhe Rrufepritësit

Sistemi i mbrojtjes ndaj shkarkimeve atmosferike do të realizohet me tokëzim natyral, duke shfrytëzuar zbritjet vertikale që do të mbyllen me një perimetral gjatë gjithë objektit, për të realizuar shkarkimin e rrymës si rezultat nga goditjet e rrufeve. Ndërtohet një sistem perimetral me përcjellës të zhveshur bakri, që do të jetë në një thellësi minimale 0.5m, me qëllim zvogëlimin

**Specifikime Teknike - Projekti Elektrik**

e tensionit të hapit. Në çatinë e godinës do të instalohen kokat me jonizim, të cilat nëpërmjet zbritjeve, do të lidhen me perimetralin e godinës.

Ato do të kenë karakteristikat e mëposhtme:



$$\Delta T = 60 \mu s$$

$$\sigma = \sigma_{PDA} < 0.44 \sigma_{PTS}$$

$$I_{imp} = 100 \text{ kA (normative test)}$$

$$I_{max} = 230 \text{ kA (Unicamp)}$$